

15.03.2022

Ora 12:00

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për mospranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr. 08,
paraqitur në KQZ në datën 11.03.2022".


PJESËMARRJA :

- KAS: Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.L.Braho.
- Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema
- Parti Politike: S'ka

Z. I. Rusmali: Mirë, ne sot jemi mbledhur për seancën përgatitore të kësaj ankese. Mbase ju nuk jeni në dijeni të praktikës që ka KQZ-ja dhe unë po ju shpjegoj pak. Në seancën përgatitore ne shohim vetëm disa gjëra që kanë lidhje me elemente të formës së ankimit. E shohim, ankimi vjen tek ne, është kompetenca jonë për ta shqyrtuar, e shohim keni të drejtë ju të paraqisni ankim, me legjitimitetin tuaj dhe pastaj shohim afatet, keni respektuar afatet për bërjen e ankimit. Këto janë tre çështjet që ne trajtojmë në këtë seancë përgatitore, pastaj marrim vendim nëse do ta shqyrtojmë apo jo? Procedura parashikon që në këtë seancë përveç ankuesit ose përfaqësuesit të tij merr pjesë edhe administrata e KQZ-së, e cila shprehet gjithashtu për të njëjtat elemente. Seancën e kemi me regjistrim. Trupa është me katër anëtarë, zoti Koli Bele për një arsye të justifikueshme nuk merr dot sot pjesë në mbledhje, megjithatë ne mund ta zhvillojmë dhe me katër anëtarë mbledhjen. E çelim seancën përgatitore duke konstatuar fillimisht pjesëmarrjen e ankuesit dhe të palës tjetër të administratës së KQZ-së që përfaqësohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Përpara se të

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

fillojmë, kërkesë për të përjashtuar ndonjë nga anëtarët, nuk ka! Zoti Merkaj, një prezantim të çështjes paraprakisht.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar Kërkesa Ankimore nr. 8, datë 11.03.2022, ora 12:50, me ankues Krenar Hasanaj, anëtar i KZAZ nr.21, Qarku Durrës, me objekt të ankimit: Kundërshtimin e vendimit nr. 111, datë 26 janar 2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka caktuar masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor në zhvillimin e zgjedhjeve të pjeshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022. Nga një verifikim paraprak i kërkesës konstatohet se kërkesa nuk është në modelin e miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për paraqitjen e kërkesës ankimore. Plotëson pjesët e tjera të formës dhe të përmbajtjes, pasi është shënuar emri i subjektit zgjedhor dhe/ose i ankuesit që ka bërë ankimin, ka vendosur bazën ligjore, ka bërë një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar, ka përshkruar faktet dhe argumentet, dispozitat ligjore mbi të cilat ai mbështet ankimin, ka treguar provat, të cilat kërkojnë të merren gjatë procesit administrativ, si dhe datën dhe firmën e ankuesit. Bazuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor është parashikuar kompetenca e KAS-it për të vështuar dhe ankimuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Është legjitimimi i ankuesit të legjitimojë në lidhje të kësaj kërkesë dhe nuk është respektuar afati i ankimit, pasi ankimohet dhe kundërshtohet vendimi i datës 26 janar 2022, në një kohë që i ka kaluar afati i ankimit kundër këtij vendimi.

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit zoti Merkaj! Zoti Hasanaj, ju e dëgjuat atë që tha Sekretari i Përgjithshëm! Çfarë keni për të thënë ju?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Ndoshta dhe nga formati që kam ankimuar edhe njëherë përpara një viti në KQZ, formatin me ato kuadratet nuk e kemi gjetur dot në KQZ, sepse dy ditët e fundit dhe *website* i KQZ-së ka qenë e bllokuar, nuk ka qenë i hapur. Megjithatë ky nuk është justifikim, unë jam munduar që t'i përmbahem mënyrës dhe radhitjes, ku është drejtuar ankimesi, vendime, në bazë ligjore, etj, etj, përveç kuadrateve besoj që dhe gjithë forma është konform ligjit. Unë nuk jam jurist, megjithatë kjo nuk më mohon të drejtën për t'u ankimuar, ndërsa për afatet ligjore, e di që ka kaluar sepse ka qenë 24 orë, por jam i mendimit që afati ligjor 24-orësh për të ankimuar një vendim, por dhe mbi masën e shpërblimit të anëtarëve të KZAZ-së nuk më duket i drejtë, pasi çfarë do ankimojë ankimesi në datën 26 janar? Unë nuk e di se çfarë vëllimi pune do kryhet.

Z. I. Rusmali: Pse ka qenë 24 orë afati? Apo, se ndërhyra, kishit ndonjë gjë tjetër për të thënë akoma?


Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Jo, jo, madje këtu e kam cituar dhe në fund fare. Pra, pa dalë vendimi i Rregullatorit...

Z. I. Rusmali: Pse të rezulton 24 orë afati? Kush është akti që mbështet afatin 24-orësh?

Z. Y. Merkaj: Afati 24-orësh për shkak të afatit të shkurtër që ka Kodi Zgjedhor...

Z. I. Rusmali: Po cili akt e përcakton këtë të drejtën e ankimit të palëve të treta brenda 24 orëve? Unë e shoh këtë dhe s'e gjej dot! Ku e kemi? Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme. Afat ankimi.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

Z. L. Braho: Është tek vendimi që ka ndryshuar rregulloren tonë.

Z. I. Rusmali: Në rregull, tek vendimi që ndryshon rregulloren, që thotë 24 orë, po!

Z. I. Rusmali: Ti ke thënë këtu zoti Hasanaj, ke thënë që nuk mund ta bëje brenda afatit, jo për shkak se afati ishte i shkurtër, por për shkak se atë kohë ti e kishe të pamundur të provoje kush do ishte ngarkesa

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Po! Sepse Rregullatori dhe Komisioneri vazhdojnë nxjerrin akte të cilat rregullojnë vëllimin e punës tonë. Atëherë këto lloj aktesh ne jemi të detyruar t'i zbatojmë deri ditën që dorëzojmë kutinë në KQZ. Atëherë, si mund t'ju provoj unë datën 25 janar se kush do të jetë vëllimi im i punës? Domethënë, Rregullatori mundej që të zgjidhte edhe zonën tonë, zonë që të votohej në mënyrë elektronike dhe në rregull, po them që mund të quhej e drejtë ajo lloj pagese 20 mijë lekë. Dhe përsa kohë ne nuk do marrim vendime, nuk do numërojmë edhe...


Z. L. Braho: Këtë ankimin e keni bërë direkt pasi keni dorëzuar kutitë...pra, keni dorëzuar kutitë e materialeve?

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Po, më 9!

Z. L. Braho: Më 9 është bërë dorëzimi dhe ankimi është bërë më datë?

Z. I. Rusmali: Më datë 11

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Më 9 e kam formuluar, më 11 e kam...


Z. L. Braho: E ke sjellë dorazi këtu në KQZ?

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Po! Se dhe ne duam një ditë, dy ditë, tre ditë që ta pjekim dhe ne në kokën tonë se fundi-fundit unë nuk jam institucion që kam staf. Unë jam një person fizik.

Z. I. Rusmali: Po ti formalisht nuk është se..., ose nuk di të them ka rëndësi apo jo, se do ta gjykojnë kolegët, por ti nuk ke kërkuar për këtë shkak rivendosjen në afat. Ti vetëm konstaton që unë mund të ankohesha ndaj një gjëje që s'e njihja në atë kohë.

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Po! Madje e kam cituar në fund që ky ankimim nuk u bë brenda afatit të caktuar, pasi nuk u njoha me vendimet e Rregullatorit dhe të Komisionerit, pasi kur procesi përfundon unë nuk kam sesi ankimohem. Çfarë do ankimohesha unë më 25 janar? Duke qenë se Komisioneri dhe Rregullatori, madje këtu unë e kam përmendur, është një vendim shumë i mirë i Komisionerit nr. 38, datë 17 nëntor 2020, ku motivon pse pagesa e një anëtari të KZAZ-së është 60 mijë lekë, ku motivohen të gjithë vëllimin e punë, madje e keni bashkëngjitur. Po tek Rregullatori në zgjedhjet e kaluara në datën 11 shkurt 2021, pra pa kaluar një muaj e gjysmë dhe ka komentuar këtë pagesë 60 mijë lekë, pikërisht për këto vëllime pune që dhe ka një komisioneri i KZAZ-së.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

Z. L. Braho: Ti ke qenë anëtar që nga fillimi?

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Po! Madje mos të them që kam 8 palë zgjedhje anëtar.

Z. L. Braho: Jo, jo po flas për këto zgjedhje.

Z. I. Rusmali: Ne s'e pyesim dot zotin Merkaj pse është ulur me 60% shpërblimi, se kjo është çështje e themelit, besoj.

Z. Y. Merkaj: Dëshira ishte për t'ia rritur sepse ne e dimë punën e tyre, dimë vështirësitë dhe jemi shumë dakord që të ishte kaq sa ishte tek vendimi 38, 750 mijë lekë.

Z. I. Rusmali: Po pse nuk u bë kjo atëherë?

Z. Y. Merkaj: Sepse ishte miratuar buxheti me Ministrinë e Financave dhe na erdhi buxheti fiks duke iu referuar pagës së vjetër me 65 mijë lekë.


Z. L. Braho: Kush e bën këtë përlllogaritje me përqindje?

Z. I. Rusmali: I kujt ishte kjo i çfarë vitit?

Z. Y. Merkaj: I vitit 2021, sepse këta historikisht e kanë shpërblimin, kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së, 65 mijë lekë. Dëshira jonë ishte që ta bënim 75 mijë lekë dhe e bëmë me vendim 75 mijë lekë. Kur u miratua buxheti i zgjedhjeve..., kjo

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

vlerë 65 mijë lekë ka të paktën katër palë zgjedhje që ka qenë 65 mijë. Ministria e Financave kështu e kishte parashikuar, 65 mijë.

Z. I. Rusmali: Ky thotë është ulur

Z. Y. Merkaj: U ul pra, u detyruam ta ulnim prapë, sepse ishte parashikuar tek 65 mijë lekëshi nga Ministria e Financave duke marrë parasysh zgjedhjet e mëparshme.

Z. L. Braho: 60-përqindëshin kush e përcakton?

Z. Y. Merkaj: Që nga 2015 deri në 2021-shin, gjithmonë kryetari dhe anëtarët e KZAZ-së marrin 65 mijë dhe 60 mijë lekë.

Z. I. Rusmali: Në rregull, pse s'po marrin tani?

Z. Y. Merkaj: Kjo pra, Komisioneri fillimisht bëri propozim që shpërblimi i tyre të jetë pak më i madh se puna është më e vështirë. E mori vendimin Komisioneri, por Ministria e Financave është bazuar tek vendimi që është 65 mijë lekë.

Z. L. Braho: Po pse e ulët prapë?


Z. Y. Merkaj: E ulëm 65 se s'kishte fonde.

Z. L. Braho: Jo 65, pse i është dhënë 25?

Z. Y. Merkaj: 25 i është dhënë se janë zgjedhje të pjesshme dhe periodha e punës në zgjedhjet normale është 90 ditë, kurse në zgjedhjet e pjesshme është 30 ditë.

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

Z. E. Çefa: Është bërë thjesht në raport me kohën.

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Rregullatori ka nxjerrë një vendim më 25 janar 2022, nr.5, në udhëzuesin e punës për zonën zgjedhore. Këtu janë të gjitha detyrat tona dhe ne e fillojmë punën në datën 27 janar, kështu që nuk është shkurtuar koha e punës. Ja ku e keni këtu, 27 janar 2022, deri në dorëzimin e materialeve zgjedhore. Kjo është periudha e punës sonë, pra, me konstituimin e KZAZ-së ne e fillojmë punën, verifikimin e listave, shpërndarjen e listave, verifikimin e listave zgjedhore...

Z. E. Lako: Mirë pra, në zgjedhje normale KZAZ-ja krijohet tre muaj para, pavarësisht se puna fillon një muaj para, kurse këto zgjedhje s'kishte tre muaj, është konstituuar një muaj para. Volumi është i njëjtë thoni ju?


Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Nuk është një muaj para, është 27 janar, me 10 ose me 9 prill. Më fal, nuk është një muaj. Këtu janë të lidhura tek detyrat që ka nxjerrë Rregullatori me vendimin e datës 25 janar 2022, këtu kemi tre faqe me detyrat e KZAZ-së.

Z. I. Rusmali: Domethënë, buxheti për shpërblimin e këtyre ju vjen si zë i ndarë më vete?

Z. Y. Merkaç: Shpjegimi ishte për vendimin 38...

Z. I. Rusmali: Dakord, mos na ço tek vendimet.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

Z. Y. Merkaj: Po, vjen zë i ndarë.

Z. I. Rusmali: Ka ardhur i pjesëtuar me tre, si zë i ndarë më vete, apo e pjesëtuar ju me tre?

Z. Y. Merkaj: Ishte shpjegimi për 38-ën, pse u ul nga 75 në 65, jo pse u ul nga 65 në 30.

Z. I. Rusmali: Ju ka ardhur nga Ministria e Financave për 65?

Z. Y. Merkaj: Këtë rastin konkret e kërkuam ne me 30, për zgjedhjet e pjeshme.

Z. I. Rusmali: Pra, ju kërkuat që shpërblimin me masën 75 për 30 ditë?

Z. Y. Merkaj: Me masën 65 për 30 ditë.


Z. I. Rusmali: Dhe ata thanë “masa 65 për 30 ditë”, pra e keni kërkuar ju kohëzgjatjen e shpërblimit?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. I. Rusmali: Dhe ka ardhur me këtë kohëzgjatje, pra me këtë masë dhe me këtë kohëzgjatje?

Z. Y. Merkaj: Po, si e kërkuam ne.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

Z. I. Rusmali: 30 ditë me shpërblim reference 65. Ne jse, kjo ka lidhje me thelbin, duhet të ndajmë njëherë do ta marrim në shqyrtim apo jo. E ndërpresim seancën këtu.

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Mos ka nevojë të flasë ndonjë njeri që puna e komisionerit ka qenë e njëjtë, nuk është se ka ndryshuar asnjë lloj gjëje.

Z. I. Rusmali: Çështja e madhe që ne duhet të trajtojmë është çështja e respektimit të afatit, sepse afati është taksativ nga Kodi. Këtë duhet ta konsultojmë me njëri-tjetrin.

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Afati s'ka qenë 30 ditë.

Z. I. Rusmali: Jo, afati i ankimit.

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Afatin e ankimit e di unë që është 24 orë.


Z. E. Çefa: Edhe sikur mos ta aplikoj ai, prapë...

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Janë larg.

Z. E. Çefa: Je një çikë larg. Edhe sikur të ishte 30 ditë.

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Unë nuk kam ardhur këtu as për pjesën materiale se nuk është që më bën ndonjë diferencë të madhe 20 mijë lekë, as të reja,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

as të vjetra. Këtu shtrohet çështja për trajtimin e komisionerit, për mënyrën e trajtimit të komisionerit. Unë e kam shkruar aty që ky është një trajtim diskriminues. Pra, ti të kërkosh një person, i cili nuk merr edhe financime nga partitë politike, nuk merr pjesë në zgjedhje, është i padënuar, është me shkollë të lartë, ka përgjegjësi penale. T'i kërkosh gjithë ato detyra, e gjithë ato lloj afatesh e t'i thuash në fund fare 20 mijë lekë. Unë po e them troç, meqenëse është edhe e regjistruar, më mirë na e bëni pa lekë, të paktën jemi vullnetarë. Sinqerisht! Është shumë më e ndershme, në qoftë se ne jemi përfaqësues të partive politike, edhe pse ne zhvishemi në momentin që ne emërohemi nga Komisioneri, më mirë po të quhet vullnetare dhe kush do ta bëjë, ta bëjë.


Z. E. Lako: Ne e hapëm këtë debat meqë edhe ju jeni munduar, sepse ne sot kemi vetëm debatin e afatit dhe plotësimin të kriterëve. Nëse ne do ta kalojmë për shqyrtim, do t'i hyjmë themelit pastaj.

Z. I. Rusmali: Të gjitha këto janë çështje që neve na lejojnë ose s'na lejojnë dot të merremi me shqyrtimin.

Z. K. Hasanaj, anëtar i KZAZ 21, Q. Durrës: Unë kisha nevojë ta thosha.

Z. I. Rusmali: Për ne u kuptua mjaft qartë që ju nuk po diskutoni për ato lekë, po diskutoni për dinjitetin e postit dhe të angazhimit tuaj, se është post njëherë të jesh komisioner, pastaj personalisht angazhim, se jo çdo njeri e bën. Këtë e kemi të qartë ne, por këtë do ta trajtonim në qoftë se do na e hapnin rrugën këto elemente. Do bëjmë një konsultë të vogël.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2022*

Rifillon seanca

Ora 12:32

Z. I. Rusmali: E çelim seancën. KAS-i pasi u konsultua në dhomë këshillimi për kërkesën ankimore të paraqitur nga zoti Krenar Hasanaj, anëtar i KZAZ-së nr.21, Qarku Durrës, vendosi moskalimin për shqyrtim të kërkesës për shkak se është paraqitur jashtë afateve detyruese ligjore të përcaktuara për KAS-in. Pavarësisht simpatisë, solidaritetit njerëzor e të gjithave, ne jemi të detyruar ta refuzojmë shqyrtimin për këtë shkak. Vendimin do ta zbardhim shumë shpejt. Ju keni të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

Vendim nr. 15

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA

